



Prishtinë: 28.06.2013

Kodi i ZRRE-së: V_546_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_978_06_13**.

në seancën e mbajtur më datë 28 qershor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa e konsumatorit K.K.V. (shifra e konsumatorit DMI – 9005250), si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij rekomandimi

A r s y e t i m

- Me datë 18.03.2011 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kërkuar shqyrtimin e njehsorit elektrik për shkak të dyshimit në mos matjen e saktë.
Provë: Kërkesa e D. së Sh. P. nr. 24/11 e datës 18.03.2011
- Me datë 15.04.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse ku kanë larguar nga matja grupin matës me numër 55996593 me gjendje TL=2691.66 kW dhe TU=0002.38 kW si dhe kanë vendosur për matje grup matësin nr. 40864417 me gjendje TL= 000000 kW dhe TU= 000000 kW. Ekipi i KEK-ut po ashtu ka evidentuar që konsumatorit duhet ti ndërrohet grupi tarifor nga 7/02 në 6/6.
Provë:Procesverbali mbi montimin e GM nr. 004801 i datës 15.04.2011
- Me datë 30.06.2011 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 55996593 ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe në brendi të njehsorit nuk është vërejtur parregullsi.
Provë: Procesverbali me nr. 1/30 i datës 30.06.2011
- Me datë 14.09.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtim njehsori kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 55996593 ku kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar matës.
Provë: Lista e shqyrtimit të njehsorit elektrik për GM nr. 10184 e datës 14.09.2012
- Me datë 21.02.2013 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke pranuar ankesën e konsumatorit bazuar në gabimin në leximin e shpenzimeve mujore dhe ka konstatuar se konsumatorit i takon korrigjimi i faturave për periudhën një vjeçare



(04/2010-05/2011) duke u mbështetur në nenin 5.11 pika 1 dhe të Kodit të matjes për OSSH-në.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 28.02.2013

- Me datë 02.05.2013 Departamenti i faturimit përmes Urdhër lejimit/ Ngarkimit nr. 18834 ka bërë korrigjimin e faturave të konsumatorit për periudhën 04/2010 deri më 03/2011 në vlerë (-30,502.76€).

Provë: Urdhër lejimit/ Ngarkimit nr. 18834 i datës 02.05.2013

- Me datë 06.03.2013, konsumatori ka apeluar përgjigjur e KEK-ut në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar faturimin nga periudha 30.07.2002 deri më datë 20.04.2011.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatori, ka vërejtur se;

- ✓ Me kërkesë të konsumatorit me datë 15.04.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja grupin matës me numër 55996593 me gjendje TL=2691.66 kW dhe TU=0002.38 kW si dhe kanë vendosur për matje grup matësin nr. 40864417 me gjendje TL= 000000 kW dhe TU= 000000 kW. Ekipi i KEK-ut në procesverbal e montimit të grupit matës po ashtu ka evidentuar që konsumatorit duhet t'i ndërrohet grupi tarifor nga 7/02 në 6/6 si dhe piks matëse vuloset (bllombohet) me vulë nr. C400011596 dhe C400011595.

Provë:Procesverbali mbi montimin e GP nr. 004801 i datës 15.04.2011

- ✓ Me datë 30.06.2011 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 55996593 ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe në brendi të njehsorit nuk është vërejtur parregullsi. Sipas të dhënave të evidentuara në procesverbal konstatohet se gjendja e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 55996593 është TL= 2691.66 kW dhe TU= 0002.38 kW.

Provë: Procesverbali me nr. 1/30 i datës 30.06.2011

- ✓ Me datë 14.09.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtim njehsori kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 55996593 ku kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar matës. Në procesverbal po ashtu është evidentuar gjendja e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik TL= 2692.626 KW dhe TU= 0002.406 kW.

Provë: Lista e shqyrtimit të njehsorit elektrik për GM nr. 10184 datë 14.09.2012

- ✓ Sipas analizës së bërë transaksioneve të konsumatorit dhe rrjedhës së energjisë aktive të shifrës DMI – 9005250 vërehet se mungojnë të dhëna për periudhë 02/2003 dhe 03/2003 pasi nuk figuron shpenzimi për këta dy muaj, pra gjatë kësaj periudhe duket sikur kjo shifër ka qenë pasive. KEK-u nuk ka treguar arsyen se pse për këta dy muaj nuk ka të dhëna kur vërehet se kur fatura e muajit 01/2003 i ka arritur konsumatorit me shifër DMI – 9005250 ajo ka qenë në parapagim me (-2,177.77 €), dhe se nuk ka të dhëna se është kërkuar nga konsumatori të pasivizohet kjo shifër.

Provë: Transaksionet e konsumatorit dhe rrjedha e energjisë aktive e shifrës DMI - 9005250

- ✓ DMK pas analizimit të protokollit mbi ndërrimin e Grupit Matës, procesverbalit të kalibrimit të KEK-ut dhe procesit të shqyrtimit të saktësisë së njehsorit elektrik të KEK-ut konstaton se gjendja e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 55996593 nuk përputhet me gjendjen e regjistruar në CCP. Gjendja e shpenzimeve e regjistruar në njehsorin elektrik në



momentin e largimit nga matja ka qenë TL=2691.66 kW dhe TU=0002.38 kW, ndërsa gjendja e evidentuar në CCP është TL= 26916.00 kW dhe TU= 23.00 kW. Në bazë të krahasimit të të dhënave konstatohet se regjistrimi i kW në CCP është bërë gabim për një shifër përkatësisht konsumatorit nga fillimi deri më 04/2011 i janë ngarkuar 24224 kW më shumë së që janë shpenzuar dhe regjistruar në Grupin Matës nr. 55996593.

Provë: Procesverbali mbi montimin e GM nr. 004801 i datës 15.04.2011, Procesverbali me nr. 1/30 i datës 30.06.2011, Lista e shqyrtimit të njehsorit elektrik për GM nr. 10184 datë 14.09.2012 dhe rrjedha e energjisë aktive

- ✓ Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK) ka kërkuar nga KEK sha që të ofroj listat e leximit për periudhën 04/2010 deri më 03/2011 me qëllim të analizimit mujor të regjistrimit të energjisë elektrike të shpenzuar nga konsumatori e të evidentuar nga lexuesi i KEK-ut. Bazuar në analizën e këtyre listave të leximit periudha 04/2010 deri më 03/2011 konstatohet se lexuesi i KEK-ut ka bërë lexim të rregullt të shpenzimeve mujore. Sipas listës së leximit periudha 02/2011 kur edhe është bërë leximi i fundit për njehsorin elektrik nr. 55996593 gjendja e shpenzimeve të evidentuara në listë nga lexuesi ka qenë TL= 26288 kW dhe TU=00023 kW, ndërsa në periudhën 03/2011 lexuesi i KEK-ut nuk ka evidentuar shpenzime.
Provë: Listat e leximit periudha 04/2010 deri më 03/2011
- ✓ Me datë 02.05.2013 Departamenti i faturimit në KEK përmes Urdhër lejimit/Ngarkimit nr. 18834 ka bërë korrigjimin e faturave të konsumatorit për periudhën 04/2010 deri më 03/2011 në vlerë (-30,502.76€). Sipas arsyetimit të KEK-ut ky korrigjim i faturave është për shkak të gabimit në lexim dhe se bazuar në Kodin e Matjes së OSSH-së neni 5.11 pika 1 dhe 2 konsumatorit i takon korrigjimi për periudhën një vjeçare. DMK konstaton se KEK sha ka gabuar me rastin e korrigjimit kur është thirrur në neni 5.11 pika 1 dhe 2 të Kodit të Matjes të OSSH-së, pasi që neni 5.11 në pikën 1 dhe 2i këtij Kodi përcakton rastet kur gabimi në matje është pasoj e defektit të njehsorit elektrik e jo si rrjedhojë e leximit jo të saktë nga lexuesit (specialistët) e KEK-ut:
 - 5.11.1. *Pas testimit të pajisjeve matëse dhe pasi që vërtetohet kufiri i pasaktësisë përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të njehsorit. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 1.5 herë e klasës së saktësisë (p.sh. për njehsorët e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0 %, kufiri i lejuar do të ishte 3.0%) atëherë bëhet ri-llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit. Kur vendoset njehsori kontrollues dhe kur vërtetohet se dallimi në lexim është 1.5 herë më i lartë atëherë veprohet siç e thamë më lartë.*
 - 5.11.2. *Në rastin kur konstatohet se njehsori ka gabuar 100%, nuk ka regjistruar fare, atëherë korrigjimi i energjisë elektrike do të bëhet sipas mesatares paraprake të shpenzimit të konsumatorit”.*
- ✓ Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike dhe transaksioneve të konsumatorit konstatohet se konsumatori ka gabime në matje nga fillimi i regjistrimit të energjisë elektrike së shpenzuar. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike konsumatori që në periudhën 04/2003 ka pasur të regjistruar 5516 kW në tarifën e lartë e që paraqet ndryshim prej 2825 kW krahasuar me protokollin mbi ndërrimin e GM datë 15.04.2011. Sipas rrjedhës së energjisë aktive vërehet se në muajin prill 2003 gjendja e tanishme e lexuar ka qenë TL=5516 kW dhe TU=0 kW, ndërsa gjendja e muajit të kaluar ka qenë: TL=488 kW dhe TU=0 kW, gjë që sipas kësaj janë regjistruar në tarifën e lartë 5028 kW apo kur shumëzohen me konstantën C=80 del se janë shpenzuar 201120 kWh për një muaj. Andaj sipas kësaj vërehet se në këtë periudhë ka ndodhur gabimi i leximit të pikës matëse. DMK konstaton po ashtu se konsumatori edhe për



periudha të gjata kohore nuk ka regjistrim të shpenzimit të energjisë elektrike dhe se konsumatori është ngarkuar vetëm me taksa (periudha 03/2004 deri më 03/2005) si dhe grumbullim të kW e të faturuar për një muaj të vetëm. Sipas këtyre analizave të bëra vërehet se KEK-u është dashur të bëjë korrigjimin e faturave të energjisë elektrike nga periudha 04/2003 e deri më 04/2011.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike dhe transaksionet e konsumatorit

- ✓ Sipas analizës së bërë rrjedhës së energjisë aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet qartë se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike e faturuar nga KEK-u me njehsorin elektrik 55996593 prej periudhës 01/2008 e deri më 04/2011 ka qenë 22867 kWh/muaj apo llogaritur në vlerë financiare prej 2341 €/muaj, ndërsa pas ndërrimit të njehsorit elektrik mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike e faturuar nga KEK-u me njehsorin elektrik 40864417 prej periudhës 04/2011 e deri më 04/2013 ka qenë 5544 kWh/muaj apo llogaritur në vlerë financiare prej 528 €/muaj.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike dhe transaksionet e konsumatorit

- ✓ Konsumatori në ankesën e tij thekson se nuk pajtohet me korrigjimin e bërë nga KEK-u pasi që gabimi i faturimit të shpenzimeve është bërë nga fillimi dhe se komuna është e dëmtuar në vlerë financiare prej 100,000 €.

Provë: Ankesa e konsumatorit

DMK në ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura e në veçanti protokollit mbi ndërrimin e GM, procesverbalit të kalibrimit dhe procesit të shqyrtimit të saktësisë së njehsorit elektrik rekomandon Bordin e ZRRE-së që të **aprovon** ankesën e konsumatorit dhe vjen në përfundim se:

1. KKDFE (KEK-u) obligohet që të shkarkoj konsumatorin me shifër DMI - 9005250 nga korrigjimi urdhër lejimi/ Ngarkimit nr. 18834 i datës 02.05.2013 në vlerë (-30,502.76 €).
2. KKDFE (KEK-u) duhet të korrigjoj faturat e konsumatori nga periudha 04/2003 deri më 04/2011 bazuar në gabimin në lexim.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. KKDFE (KEK-u) obligohet që të shkarkoj konsumatorin me shifër DMI - 9005250 nga korrigjimi urdhër lejimi/ Ngarkimit nr. 18834 i datës 02.05.2013 në vlerë (-30,502.76 €).
 2. KKDFE (KEK-u) duhet të korrigjoj faturat e konsumatori nga periudha 04/2003 deri më 04/2011 bazuar në gabimin në lexim.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar